



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/43

Datë: 13.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2020, merr këtë:


V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2020

1. Ndryshohet dhe plotësohet Programi Legjislativ për vitin 2020 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, si në vijim:
 - 1.1. Shtyhet afati i miratimit në Qeveri, i këtyre projektligjeve:
 - 1.1.1. Projektligji për Partneritetin Publiko-Privat (MF), afati i miratimit 30.11.2020;
 - 1.1.2. Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal (MF), afati i miratimit 30.11.2020;
 - 1.1.3. Projektligji për Lotarinë e Kosovës (MF), afati i miratimit 30.11.2020;
 - 1.1.4. Projektligji për Borxhin Publik (MF), afati i miratimit 30.11.2020.
2. Tërhiqen nga Programi Legjislativ për vitin 2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe barten për vitin 2021:
 - 2.1.1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave (MF);
 - 2.1.2. Projektligji për Agjencinë e Tatimeve dhe Doganës (MF);
 - 2.1.3. Projektligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat (MF);
 - 2.1.4. Projektligji për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo Bankare (MF);
 - 2.1.5. Projektligji për Tatim në të Ardhurat Personale (MF);
 - 2.1.6. Projektligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (MF).
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit që vendimin t'ia dërgojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOFI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/43

Datë: 13.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07 -P- 77 të datës 22.09.2020, jep mendim lidhur me nismën Legjislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-172, si në vijim:
 - 1.1. Nisma legjislative nga pika 1. e këtij Vendimi nuk ka përcaktuar periudhën kohore prej kur fillon të llogaritet kontributi i dhënë për lirinë e vendit, i cili do të shërbente si bazë për realizimin e të drejtave siç përcaktohen në ligjin bazik;
 - 1.2. Për shkak të gjendjes aktuale socio-ekonomike, si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19 dhe vështirësive buxhetore nëpër të cilën po kalon vendi;
 - 1.3. Duke pasur parasysh se Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, në mendimin e saj për nismën legjislative të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, ka konstatuar se nuk është bërë identifikimi i burimeve të financimit në ndarjet tjera buxhetore për mbulimin e kostos shtesë, prandaj nuk ka rekomanduar aprovimin e këtij plotësim ndryshimi.
 - 1.4. Nisur nga rrethanat e lartcekura, Qeveria e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 19 paragrafi 5 të Ligjit nr. 07/L-001 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, dhe deri në krijimin e rrethanave të reja më të favorshme buxhetore, ofron mendimin e saj që një nismë e tillë ligjore të mos aprovohet nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Ky Vendim së bashku me mendimet e ministrive përkatëse i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HODI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/43

Datë: 13.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Aktet Juridike.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/43

Datë: 13.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/43

Datë: 13.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-015 për Letërnjoftim.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/43

Datë: 13.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/43

Datë: 13.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 43 të Ligjit 03/L-16 për Ushqimin, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr.09/27 të datës 30.04.2020 për emërimin e anëtareve të Bordit Drejtues të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1, paragrafi 1.7 i Vendimit të Qeverisë Nr. 09/27 të datës 30.04.2020, si në vijim:

1.7 Në vend të z. Valdet Gjinovci, anëtar, emërohet z. Naser Krasniqi nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 09/27 të datës 30.04.2020.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Shefit të Stafit të Kryeministrit
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/43

Datë: 13.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit 03/L-016 për Ushqimin, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr.10/27 të datës 30.04.2020 për emërimin e anëtareve të Këshillit Shkencor të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1, paragrafi 1.4 i vendimit të Qeverisë Nr.10/27 të datës 30.04.2020, si në vijim:
 - 1.4. Në vend të z. Imer Haziri, anëtar, emërohet znj. Rreze Gecaj nga Fakulteti i Bujqërisë dhe Veterinarisë -FBV.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit të Qeverisë Nr. 10/27 të datës 30.04.2020.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/43

Datë: 13.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit 03/L-016 për Ushqimin, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr.01/33 të datës 19.05.2020 për emërimin e anëtareve të Këshillit Shkencor të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1, paragrafi 1.5 i vendimit të Qeverisë Nr. 01/33 të datës 19.05.2020, si në vijim:
- 1.5. Në vend të z. Imer Rusinovci anëtar, emërohet z. Sali Aliu nga Fakulteti i Bujqërisë dhe Veterinarisë -FBV.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit të Qeverisë Nr. 10/27 të datës 30.04.2020, si dhe vendimit të Qeverisë Nr.01/33 të datës 19.05.2020.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/43

Datë: 13.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 62 pika 3 e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për aprovimin e Buxhetit për Komunën e Novobërdës pas aprovimit të Buxhetit për vitin 2021 nga Kuvendi Komunal i Novobërdës, me datë 26.10.2020.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me tabelat t'i procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Komuna e Novobërdës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/43

Datë: 13.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 30 pika 3 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-221; Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr.05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për transferin e mjeteve nga kategoria e shpenzimeve "mallrat dhe shërbimet" në kategorinë e shpenzimeve "shpenzime kapitale" në shumë prej një milion e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë euro (1,194,550 €).
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Ministria e Shëndetësisë me kod 206, nga nën programi Administrata qendrore me kod 11306, nga kategoria e shpenzimeve "mallra dhe shërbime" burimi i financimit 04-Huamarrja dhe transferohen në nën programin Shërbimet Përkatëse Farmaceutike me kod 71300 në kategorinë e shpenzimeve "shpenzime kapitale", në projektin "Pajisjet mjekësore" me kod 15886, me ç' rast këtij projekti i shtohet burimi i financimit huamarrja për arsye të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, për furnizim me pasje speciale mjekësore për nevoja të SHSKUK sipas letër ristrukturimit nga Banka Botërore.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/43

Datë: 13.11.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 dhe 50 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Ekzekutiv për Reformën në Fushën e Inspektiveve në këtë përbërje:
 - 1.1. Zëvendëskryeministri i parë, Kryesues;
 - 1.2. Ministri i MTI-së, Zëvendës kryesues;
 - 1.3. Ministri i MPB-së, anëtar;
 - 1.4. Sekretarja e Përgjithshme e MPL-së, anëtare;
 - 1.5. Drejtori i Zyrës për Planifikim Strategjik, ZKM, anëtar;
 - 1.6. Drejtori i Zyrës Ligjore, ZKM, anëtar;
 - 1.7. Drejtori i Departamentit Ligjor, MTI, anëtar;
 - 1.8. Drejtori i Departamentit të Buxhetit, MF, anëtar;
 - 1.9. Drejtori i Departamentit Ligjor, MPL-së, anëtar.
2. Komisioni Ekzekutiv gjithashtu obligohet të ftojë përfaqësues të shoqërisë civile, sektorit privat, institucioneve të tjera dhe donatorëve ndërkombëtar për të marrë pjesë në mënyrë aktive në punën e tij në cilësi të ekspertëve dhe/ose vëzhguesve.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Komisionit Ekzekutiv për këtë reformë me interes nacional, janë si vijon:
 - 3.1. Koordinimi, drejtimi dhe mbikëqyrja e aktiviteteve të organeve të ndryshme qeveritare për zbatimin e aktiviteteve që ndërlidhen me reformën e fushës së inspektiveve;
 - 3.2. Koordinimi i aktiviteteve me institucionet e pavarura dhe nivelin lokal sa i përket reformës në fushën e inspektiveve;
 - 3.3. Përgatitja e propozimeve dhe projekt-vendimeve të nevojshme për zbatimin e suksesshëm të reformës në fushën e inspektiveve për vendosje nga organet kompetente Qeveritare, duke përfshirë propozimin për racionalizimin e numrit të inspektorateve dhe koordinimin më të mirë të tyre që pritet të dorëzohet në mbledhjen e Qeverisë për miratim;
 - 3.4. Mbikëqyrja e procesit të hartimit legjislativ të nevojshëm për implementimin e reformës në fushën e inspektiveve, duke përfshirë sigurimin e udhëzimeve të nevojshme të politikave në përputhje me Koncept Dokumentin e aprovuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 17/35 të datës 09.03.2018;

- 3.5. Mbikëqyrja e grupeve të specializuara në kuadër të organeve qeveritare ose grupeve të specializuara ndër-qeveritare të cilat themelohen me kërkesë të Komisionit Ekzekutiv dhe i raportojnë atij, për trajtimin e çështjeve të caktuara lidhur me këtë reformë;
 - 3.6. Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve të nevojshme udhëzuese për implemtimin e suksesshëm të reformës në fushën e inspektimeve;
 - 3.7. Zhvillimi i aktiviteteve të tjera të nevojshme për implementimin e suksesshëm të reformës së inspektimeve në përputhje me Koncept Dokumentin e aprovuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 17/35 të datës 09.03.2018.
4. Brenda dyzet e pesë (45) ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Komisioni Ekzekutiv do të hartojë dhe aprovojë Rregulloren e tij të Punës dhe Planin e Veprimit për zbatimin e Reformës në Fushën e Inspektimeve.
 5. Të gjitha organet dhe zyrtarët qeveritar obligohen që të bashkëpunojnë me Komisionin Ekzekutiv gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në këtë vendim.
 6. Mbledhjet e Komisionit Ekzekutiv mbahen vetëm nën kryesimin e zyrtarëve të emëruar në pikat 1.1 ose 1.2 të këtij vendimi.
 7. Shërbimi në Komisionin Ekzekutiv trajtohet si pjesë e detyrave të rregullta të punës të të gjithë anëtarëve.
 8. Të gjithë anëtarët e Komisionit Ekzekutiv obligohen që të marrin pjesë personalisht dhe vazhdimisht në të gjitha mbledhjet e thirrura. Në raste të jashtëzakonshme, kur pjesëmarrja nuk është e mundur, anëtari përkatës obligohet që të njoftojë Kryesuesin dhe Zëvendës Kryesuesin për mungesën dhe të kërkojë aprovim për zëvendësimin e tij/saj nga një person tjetër nga institucioni i njëjtë.
 9. Në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në këtë vendim, Komisioni Ekzekutiv mbështetet në aspekt administrativ dhe profesional nga Zyra për Planifikim Strategjik dhe Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit dhe Departamenti Ligjor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Mbështetje në aspekt profesional do të ofrojë edhe Projekti i Bankës Botërore i Konkurrueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport dhe Projekti i IFC për Përmirësimin e Klimës së Investimeve, financuar nga Qeveria Zvicerane.
 10. Organizimi dhe modalitetet tjera të mbështetjes administrative dhe profesionale vendosen në mbledhjen e parë të Komisionit Ekzekutiv.
 11. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/43

Datë: 13.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Ndërmarrja Publike Lokale "Përparimi" Sh. A., Vushtrri.
2. Ndërmarrja Publike Lokale - NPL "Përparimi" Sh. A. themelohet me 100% aksione nga KK Vushtrri.
3. Komuna e Vushtrrisë autorizohet që të veprojë në emër të aksionarit të vetëm në NPL "Përparimi" Sh. A. dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e ligjshme, duke përfshirë regjistrimin sipas Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare (G.Z. nr. 9/2018).
4. Komuna e Vushtrrisë të drejtat e saj të aksionarit do t'i ushtroj përmes Komisionit Komunal të Aksionarëve, e cila këtë ushtrim do e bëjë në emër të Komunës përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Obligohet Komuna e Vushtrrisë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/43

Datë: 13.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3, 4, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit: Zgjerimi i rrugës Nacionale N2 segmenti "Hyrja në Qytetin e Prishtinës" (Veternik), Ura dhe Zgjidhja e Nyjës që lidhë Rrugët Nacionale N2 me N25.2 dhe Kyqjen e Autostradës R7, Zona Kadastrale: Çagllavicë, Komuna e Prishtinës, sipas tabelave bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të objekteve të vjetruara do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Financave dhe Komuna e Prishtinës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/43

Datë: 13.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për nënshkrimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Ekonomik ndërmjet Ministrisë së Tregtisë së Republikës Popullore të Bangladeshit dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë së Republikës së Kosovës, në fushat e tregtisë, industrisë, bujqësisë, transportit telekomunikacionit/TIK, turizmit, arsimit, sportit, shëndetësisë, investimeve e të ngjashme.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/43

Datë: 13.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti mbi nivelin e ekzekutimit të projekteve të huamarjes ndërkombëtare.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/43

Datë: 13.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë